



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "DMAX EXPERT" Sh.P.K. të datës 27.03.2024, kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "S.V. Veterina" të datës 26.03.2024 si dhe sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "LAN Group" të datës 25.03.2024, kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-2103-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "DMAX EXPERT" Sh.P.K. e datës 27.03.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-2103-2-1-1.
- II. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "S.V. Veterina" e datës 26.03.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-2103-2-1-1.
- III. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "LAN Group" Sh.P.K. e datës 25.03.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-2103-2-1-1.
- IV. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- V. **NJOFTOHEN** të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Operatori ekonomik "DMAX EXPERT" Sh.P.K. me datë 27.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-2103-2-1-1.

Operatori ekonomik "S.V. Veterina" me datë 26.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-2103-2-1-1.

Operatori ekonomik "LAN Group" Sh.P.K. me datë 25.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-2103-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesave për rishqyrtim të parashtruesve është gjetur se kërkesat janë të lejuara dhe janë parashtruar brenda afatit nga personat e autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesat. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesave.

**Pretendimet e operatorit ekonomik "DMAX Expert" Sh.P.K. janë formuluar si në vijim:**

*"AK kërkesat e vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit të përshkruara edhe me rregullat përmbajtësore në Aneksin 7, PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM dhe Aneksin 1 tek Specifikimet teknike të detyrueshme ka ra në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik. Përshkrimi i detajuar i preparateve për realizimin e shërbimeve. Kopje e listes teknike e sigurisë - Safety Data Sheet (SDS), ose MSDS dhe kopje e certifikates se analizave te produktit nuk janë të definuara saktë dhe se kjo kerkese mendojmë se kufizon në mënyrë direkte konkurrencën Autoriteti Kontraktues me rastin e hartimit të këtyre kërkesave ka rënë në kundërshtim edhe me ligjet tjera pasi që tejkalon kompetencat e veta si institucion dhe ndërhyr në kompetencat dhe autorizimet e institucioneve tjera relevante e sanitare".*

**Lidhur me pretendimet ankimore të "DMAX Expert" Sh.P.K. duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Në përputhje me sqarimet e ofruara nga njësia kërkuese është gjetur se të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas aneksit 7 të dosjes së tenderit – pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm si dhe në aneksin 1 specifikimet teknike të detyrueshme janë në përputhje të plotë fillimisht me nevojat e njësisë kërkuese pastaj me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe mbi të gjitha me parimet themelore të prokurimit publik duke përfshirë por pa u kufizuar në parimin për mosdiskriminin/mosfavorizim sipas nenit 7 të LPP si dhe nenit 28 të LPP.**

Të gjitha pasijet/mekanizmat e kërkuara përmes dosjes së tenderit dhe kërkesat tjera janë apsolutisht të domosdoshme për të realizuar me sukses, me efikasitet si dhe me efektivitet kontratën që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Ngjashëm vlen edhe sa i përket kërkesës për përshkrimin e detajuar të preparateve, kopjen e listës teknike të sigurisë SDS ose MSDS, kopjen e çertifikatës së analizave të produktit dhe kërkesat tjera të dosjes së tenderit. Të gjitha këto kërkesa janë të domosdoshme dhe minimale për të siguruar cilësinë e nevojshme të shërbimeve që kërkohen përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Në asnjë pjesë të kërkesës për rishqyrtim, parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë fakt apo argument për të dëshmuar të kundërtën. Në këtë mënyrë është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore të "DMAX Expert" janë të pabazuara.

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

**Pretendimet e operatorit ekonomik "S.V. Veterina" janë formuluar si në vijim:**

*"Me këtëkërkesë të përcaktuara nga AK lidhur me Qarkullimin duke mundësuar 51% lideri, është kufizues dhe favorizues sepse shume OE të specializuar në DDD nuk ju mundësohet të ofertoj, sepse vlera 900000 Euro për tri vite eshë e madhe për tregun e Kosovës.*

*Artikujt që janë përmendur në këtë specifikacion teknik dhe përveç emrave AK ka përmendura se mund të aplikojmë edhe me "EKIVALENT", kjo është në kundërshtim me nenin 28 të LPP*

*Pajisja me nr. 2 Pompa motorike sprayer dhe keto kërkesa janë kufizuese, diskriminuese dhe jo konkurrencë fer dhe e drejt.*

*Automjetet duhet të jenë të pajisura me GPS monitorues., Çafra i duhet AK Automjetet me GPS, kjo s'ka logjike, sepse AK po kontraktton shërbime.*

*Kjo kërkesë është shume kuptimshme dhe shumëdimensionale dhe është e pamatshme, prandaj kjo duhet të specifikohet me saktë dhe të mos i i'pet mundësi AK - Komisionit të vlerësimit, ZPP të eliminoj OE sepse prefekt me bere metodologjinë, parësi ka hapësirë me thën nuk është sipas Aneksit 1 të FDT-se, sepse kjo është tërësisht e pa mateshe, ka shumë kuptim dhe tërësisht subjektive, andaj kërkojmë të hartohet në atë mënyrë që të jete e mateshe specifik edhe e saktë, duke përcaktuar kritere e kërkesa dhe jo METOLOGJIA E PUNESE – sepse secili OE ka metodologjinë e vete të punës dhe mund dhe është normale të dalloj, por AK të DIN çka po KEKRON dhe MOS të kërkoj dika që nuk MUND TA MAT. apo thëna ndryshe e din vec ai që do ta merr.....apo e ka mira vetëm ky që do të tenderoj etj etj".*

**Lidhur me pretendimet ankimore të "S.V. Veterina" fillimisht duhet sqaruar se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar në kundërshtim të plotë me nenin 60 par. 60.1 të RRPP përmes të cilit përcaktohet se "Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni kërkesat për rishqyrtim".** Kjo pasi që kërkesa për rishqyrtim nuk është ngarkuar në eprokurim përmes formularit F02 por është dorëzuar si formular për sqarime shtesë.



Pra kjo kërkesë për rishqyrtim duhet të refuzohet si e pabazuar duke u bazuar në nenin 62 par. 62.1 të RRPP përmes të cilit përcaktohet se *“Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj rregullore”*.

Sidoqoftë autoriteti kontraktues ka gjetur po ashtu se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara. Në këtë drejtim duhet cekur nenin 10 par. 10.3 të RRPP përmes të cilit është përcaktuar se njëzia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njëzia kërkuuese.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit lidhur me qarkullimin e kërkuar në shumën 900,000.00 për 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë (51% lideri të GOE), duhet cekur se vlera e parashikuar e kontratës për të cilën është parashtruar pretendimi ankimor është pikërisht 900,000.00 euro. Pra pretendimi ankimor është totalisht i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit lidhur me lejimin e pajisjeve ekuivalente me pajisjet e kërkuara përmes dosjes së tenderit, vlen të thuhet se ky pretendim ankimor është mjaft kundërthënës pasi që parashtruesi pretendon se fakti që lejohen ekuivalenca është kërkesë diskriminuuese. Përmes nenit 28 par. 7 të LPP është përcaktuar se *“Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët -ose ekuivalent-”*. Prandaj ky pretendim ankimor është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket kërkesës *“Automjetet duhet të jene të paisura me GPS monitorues”* dhe kërkesat tjera të dosjes së tenderit, të gjitha këto kërkesa janë të domosdoshme dhe minimale për të siguruar cilësinë e nevojshme të shërbimeve që kërkojnë përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Në asnjë pjesë të kërkesës për rishqyrtim, parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë fakt apo argument për të dëshmuar të kundërtën. Pajisjet GPS janë mekanizmi më i thjeshtë i mundshëm për të mundësuar kontrollin dhe dëshminë e nevojshme për përmbushjen e kontratës në përputhje me kushtet dhe rrethanat përkatëse sipas DT.

Sa i përket pretendimit për dorëzimin e metodologjisë së punës dhe planit dinamik, duhet cekur se kjo kërkesë është mjaft precize dhe shumë lehtë e kuptueshme. Sipas DT kjo kërkesë përmbushet kur të dorëzohet dëshmia e kërkuar dokumentare e cila është

“Përshkrimi i kërkuar i metodologjisë së punës”. Kush e dorëzon këtë dokument sipas kërkesës së DT do të konsiderohet se e ka përmbushur këtë kërkesë dhe anasjelltas. Pra këtu nuk ka asgjë të pakuptueshme, të pamatshme apo të paligjshme sikurse pretendon parashtruesi. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara prandaj edhe kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

**Pretendimet e operatorit ekonomik “LAN Group” Sh.P.K.** janë formuluar si në vijim: *“Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT Dëshmi e dokumenteve :3.Lista e pajisjeve sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve. Andaj kur e shikon Ankesin 7 shkruan :Automjete për bartjen e punëtorëve dhe pajisjeve tjera përcjellëse. Automjetet duhet te jene te paisura me GPS monitorues. Kjo kerkese eshte aq diskriminuese e aq favorizuese edhe aspak nuk i sherben ketije aktiviteti te prokurimit qe automjetet e OE te jene ne GPS. Qka i duhen GPS autoriteti ne fjale kur sherbimi ka mu monitiru ne vazhdmisi nga Menagjeret e Kontrates andaj kerkoje qe ky kriter te largohet gjithesesi pasi qe eshte favorizim i qarte ndaj nje OE”*.

**Lidhur me pretendimet ankimore të “LAN Group” Sh.P.K.** duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore.

Në përputhje me sqarimet e ofruara nga njësia kërkuuese është gjetur se të gjitha kërkesat e përcaktuara sipas aneksit 7 të dosjes së tenderit – pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm si dhe në aneksin 1 specifikimet teknike të detyrueshme janë në përputhje të plotë fillimisht me nevojat e njësisë kërkuuese pastaj me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe mbi të gjitha me parimet themelore të prokurimit publik duke përfshirë por pa u kufizuar në parimin për mosdiskriminin/mosfavorizim sipas nenit 7 të LPP si dhe nenit 28 të LPP. Të gjitha pasijet/mekanizmat e kërkuara përmes dosjes së tenderit dhe kërkesat tjera janë apsolutisht të domosdoshme për të realizuar me sukses, me efikasitet si dhe me efektivitet kontratën që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Ngjashëm vlen edhe sa i përket kërkesës *“Automjetet duhet te jene te paisura me GPS monitorues”* dhe kërkesat tjera të dosjes së tenderit. Të gjitha këto kërkesa janë të domosdoshme dhe minimale për të siguruar cilësinë e nevojshme të shërbimeve që kërkohen përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Në asnjë pjesë të kërkesës për rishqyrtim, parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë fakt apo argument për të dëshmuar të kundërtën. Në këtë mënyrë është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore të “LAN Group” janë të pabazuara.



Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesit nuk kanë paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tyre. Prandaj kërkesat për rishqyrtim të parashtruesve janë refuzuar si të pabazuara në tërësi.

Për pikën I, II, III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën V dhe VI të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 02.04.2024**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.